



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:070838  
Datë: 27.09.2023  
Numri i dokumentit: 04724318

SCC-11-0030

**H (A) L**Kaçanik.

*Paditësi:*

*Kundër*

*E Paditura:*

- 1. OPB “Mladost”, Shtërpcë, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr.’’ Dritan Hoxha nr.55 , Lakrishtë, Prishtinë.**
- 2. K K.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Shkelzen Sylaj kryesues, Diellza Hoxha dhe Hasim Sogojeva gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 27 shtator 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Padia e paditësit H (A) L, refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 27 janar 2011, paditësi ka paraqit padi në Dhoma e Posaçme (tutje DHP), kundër të paditurave për vërtetimin e pronësisë. Paditësi ka theksuar se është djali i tani të ndjerit A A L i cili ishte pronar i pasurive-parcelave: nr.72 në sipërfaqe prej 00.64.03 ha, nr. 84 me sipërfaqes prej 00.02.52 ha, nr. 85 me sipërfaqe prej 00.11.25 ha, nr. 86 me sipërfaqe prej 00.20.00 ha, nr. 107 me sipërfaqe 00.03.23 ha, dhe ngastrës nr 108 me sipërfaqe prej 00,25.76 ha, në sipërfaqe të përgjithshme prej 01.26.79 ha – ZK – S K e K. Ka shtuar se në vitin 1962 organet shtetërore

të atëherëshme pasurinë e babait të tij, pa bazë juridike në mënyrë kundërligjore e kanë bartur si pasuri shoqërore në emër të kooperativën bujqësore “Ramadan Agushi” në Kaçanik dhe që me pastaj është bartur në emër të paditurës së dytë pasurisë bujqësore “Mlladost”- Shtërpcë. Si provë ka bashkangjitur certifikatën e lindjes për H L lëshuar me dt.23 nëntor 2010, Certifikatën e vdekjes A L lëshuar me dt 18 janar 2011, fletën poseduese lëshuar me dt. 22 nëntor 2010. I ka propozuar gjykatës që padinë e tij ta aprovoj si të bazuar.

Me 14 shkurt 2011, gjykata me urdhër ka kërkuara nga paditësi, që të dorëzoj vendimin e trashëgimisë.

Me 07 mars 2011, paditësi ka dorëzuar një parashtrëse, përmes së cilës e ka njoftuar gjykatës se ai, ka iniciuar procedurë ligjore për shqyrtimin e trashëgimisë.

Me 09 korrik 2015, gjykata e ka dërguar padinë e paditësit tek të paditurat në mënyrë që të ato të parashtrojnë mbrojtje në padi.

Me 21 korrik 2015, e paditura AKP ka ushtruar mbrojtje në padi, ku ka theksuar se kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke shtuar se padia e paditësit nuk përmban bazën ligjore, mbi të cilën do të mbështetet padia e tij. Po ashtu e paditura ka theksuar se paditësi nuk ka legjitimitet aktiv të palës në procedurë, meqë i njëjti nuk ka prezantuar aktvendimin e trashëgimisë. E paditura në mbrojtjen e saj i është referuar edhe nenit 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar, i cili është i aplikueshëm në bazë të Rregullores së UNIMIK-ut numër 1999/24 për ligjin në fuqi në Kosovë, me të cilën parashihet se *“nëse palujshmeria është bere mjete ne pronësinë shoqërore pa bazë juridike, kthimi i saj mund të kërkohe në afat prej 5 (pesë) vjetësh duke e filluar nga dita e njoftimit kurse me se voni në afat prej 10 (dhjete) vjetësh”*. Kështu që në këtë bazë juridike është parashkruar kërkesa e palës paditës për të kërkuar kthimin eventual të palujshmerisë në procedurë gjyqësore.

E paditura i është referuar edhe një aktgjykimi të DHPGJS-se me numër SCC-09-0098 ku i është refuzuar padia e një personi po me këtë bazë juridike. Gjithashtu i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar.

Me 03 gusht 2015, edhe e paditura Komuna e Kaçanikut ka parashtruar mbrojtje ndaj padisë së paditësit duke theksuar se në bazë të hulumtimeve të historikut lidhur me palujshmerinë të cilin e kërkon paditësi ka hasur në dokumentacion se me vendimin e Këshillit Popullor të Komunës së Kaçanikut numër 1033 të datës 25 prill 1962 paraardhësi i paditësit ishte shpallur uzurpues i pronës shoqërore. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj padinë e paditësit si të pa bazuar.

Me 27 gusht 2015, gjykata me urdhër i ka dërguar mbrojtjen e të paditurave paditësit në mënyrë që paditësi të mund të paraqes përgjigje ndaj mbrojtjeve, mirëpo paditësi nuk ka parashtruar përgjigje.

Me 13 shtator 2023, gjykata mbajti seance dëgjimore në këtë çështje juridike, ku paditësi dhe të paditurat ishin prezent në seancë. Edhe në seancën dëgjimore dhe në fjalën e tyre përfundimtare palët deklaruan se mbesin në tersi pranë pretendimeve të tyre të paraqitura si me herët.

Për detaje tjera referimi bëhet tek dosja e lëndës.

## Arsyetimi Ligjor

Padia e paditësit refuzohet si e pa bazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në rast të një kërkesë padi në lidhje me të drejta mbi një pasuri të trashëguara siç pretendon paditësi, Gjykata duhet të shqyrtoj edhe ex officio nëse të gjithë trashëgimtarët janë të përfaqësuar. Por tek ky rast edhe e paditura e kontestuar legjitimitetin aktiv që nga fillimi dhe paditësi nuk e ka provuar atë. Aktvendimi i trashëgimisë është i vetmi dokument për të treguar-dëshmuar në mënyrë të mjaftueshëm pozitën e trashëgimtarëve.

Gjykata me urdhrin e datës 14 shkurt 2011, kërkoj nga paditësi që të dorëzojë vendimin e trashëgimisë, në mënyrë që të dëshmohet legjitimiteti aktiv i palës në procedurë, i cili është veprim i para procedurale që gjykata duhet ndërmer para se të shkohet në çështjen kryesore. Gjykata përmes urdhrin e njoftoj paditësin për pasojat në rast të mos përmbushjes së urdhrin. Mirëpo meqë paditësi me dt. 07 mars 2011, dorëzoj një parashtrere, përmes se cilës e njoftoj gjykatën se ai ka iniciuar procedure ligjore për shqyrtimin e trashëgimisë, gjykata vazhdoj me procedurën e shkruar në mënyrë që paditësit ti jepet kohë e mjaftuar për ta shqyrtuar trashëgimin, por ai përsëri nuk e provoj legjitimitetin aktiv.

Megjithatë edhe pse paditësi nga viti 2011, nuk prezantoj aktvendimin e trashëgimisë, gjykata padinë e paditësit nuk e hodhi poshtë si të papranueshme dhe thirri palët në seance dëgjimore duke i dhen edhe një mundësi paditësit që ta prezantoj aktvendimin e trashëgimisë, por paditësi përsëri dështoj ta dorëzoj atë. Ai madje as në seancë nuk kërkoj shtyrjen e seancës për ta siguruar aktvendimin e trashëgimisë. Parashtrera e paditësit e dorëzuar me dt. 25 shtator 2023, për dhënin e afatit shtesë për të dorëzuar aktvendimin e trashëgimisë është e papranueshme, pasi që kjo parashtrësë është dorëzuar pasi është mbyllur seanca dëgjimore dhe ka përfunduar procedura me shkrim dhe ajo verbale. Siç edhe arsyetuaam më lartë paditësi kishte mundësi që ta dorëzoj aktvendim e trashëgimisë që nga dt. 14 shkurt 2011, kur gjykata me urdhër ka kërkoj nga ai, por ai zgjodhi të mos e bëjë këtë as deri në përfundimin e seancës përmbyllëse.

Po ashtu gjykata nënvizon se paditësi edhe me parashtrësën e dt. 07 mars 2011, e kishte njoftuar gjykatës se ai kishte iniciuar procedure ligjore për shqyrtimin e trashëgimisë, mirëpo ai asnjëherë nuk i dorëzoj gjykatës aktvendimin e trashëgimisë, andaj kërkesa e tillë e paditësit është jo serioze dhe si e tillë e papranueshme, aq me tepër kur edhe nenin 9.1 i ligjit të DHPGJS, obligon gjykatën që të lëshoj Aktgjykim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e përfundimit të procedurave me shkrim dhe asaj verbale.

Certifikata e vdekjes për paraardhësin e tij dhe certifikata e lindjes së paditësit, nuk janë dëshmi që e zëvendësojnë aktvendimin e trashëgimisë. Gjykata konstaton se dëshmitë e dorëzuara nga paditësi në bazë të nenit 171.1 lidhur me 178.1 të ligjit të Procedurës jo kontestimore, nuk janë të mjaftuara pasi që në bazë të këtyre dispozitave kërkohet aktvendimi i trashëgimisë.

Kjo tashmë rezulton se paditësi nuk e ka dëshmuar faktin se ai është trashëgimtar dhe i vetmi trashëgimtar të paraardhësit të tij të ndjerit A A L. Gjykata nuk mundet thjesht të supozojë se kështu është gjendja dhe kjo nuk dëshmohet me dëshmi vdekjeje, certifikatën e vdekjes apo certifikatën e lindjes, por kjo duhet të dëshmohet me aktvendimin e trashëgimisë.

Meqë paditësi nuk e ka provuara legjitimitetin aktiv sepse trashëgimia nuk është dëshmuar, paditësi duke marrë parasysh se një ditë do të dëshmojë pozitën e tij si trashëgimtarë me anë të aktvendimit të trashëgimisë, ai mund të paraqesin një padi të re.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar Kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Hasim Sogojeva, Gjyqtar